



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	z.Kujtim Shala- Ministër i Kulturës,Rinisë dhe Sportit				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Veton Firzi - Sekretar i Përgjithshëm /MKRS-së				
NGA/OD/FROM:	Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit/MKRS-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aprovimi i politikës programore nr.1 – Politika Programore për avancimin e sportit Femërorë				
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357	Data:	31
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	Janar
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)	Date:	2015

Këtij dokumenti i është bashkëngjitur propozim-politika numër një (1) – programi i Departamentit të Sportit për zbatimin e politikës së sportit të femrave.

Kjo politikë programore ka qëllim ngritjen e nivelit të sportit tek femrat, duke përfshirë të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë, dhe të gjejë mënyra për të bërë sensibilizimin e opinionit për sportin femëror, të masivizojë, të përkrahë dhe inkurajojë gjithë përfshirjen e femrës në punë profesionale, punë të drejtpërdrejt organizative e udhëheqëse në klube e federata dhe administrim të sportit.

Politika programore propozohet në tërësi, në interes të sportit të femrave si dhe avancimin e sportit në përgjithësi.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën prej 270,000.00 €.

z.Veton Firzi  
Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z.Kujtim Shala  
Ministër i MKRS-së

Ministria e kulturës rinisë dhe sportit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore: (1) SPORTI I FEMRAVE

### Hyrje

Përmes kësaj politike programore përkrahjet dhe mbështetet zhvillimi i sportit të femrave, duke pasur në konsideratë vështirësitë nëpër të cilat kalon shoqëria jonë dhe vetë aktiviteti sportiv i femrave.

Është konstatuar edhe nga viti i kaluar se ka klube sportive dhe federata të sportit të cilat zhvillojnë aktivitete sportive por vazhdimisht ballafaqohen me vështirë të natyrës materiale edhe në rastet kur kemi të bëjmë me klube të suksesshme.

Kësaj duhet t'i shtohet edhe nevoja për të stimuluar vazhdimësinë e aktivitetit avancimit mëparshme të femrave.

### Historiku

Perfshirja e kesaj politike programore, me qellim te masivizimit, zhvillimit dhe avancimit te sportit te femrave, eshte bere qe nga viti 2001. Që nga viti 2001, është aplikuar kjo politikë programore, duke synuar të ndihmojë zhvillimin e sportit femëror përmes përkrahjes me rekuizita sportive, kampe verore dhe mbështetje materiale për mbulimin e shpenzimeve të regjistrimit/licencimit, pagesave për zyrtarë, transport dhe uniformë reprezentative të sportit.

### Qëllimi / Objektivi

Kjo politikë programore ka qëllim ngritjen e nivelit (dhe avancimin) e sportit tek femrat, duke përfshirë të gjitha komunitetet që zhvillojnë aktivitet sportiv. Synimi i kësaj politike është sensibilizimi i opinionit të sportit femëror dhe opinionit të gjere, masivizimi, përkrahja dhe inkurajimi ne përfshirjen e femrave në punë profesionale, punë të drejtpërdrejta organizative e udhëheqëse në klube, federata, KOK dhe administrim të sportit.

MKRS - Departamenti i sportit do të fuqizoj këtë politikë duke e inkorporuar në politikat tjera programore sipas projekteve dhe prioriteteve.

## Strategjia dhe Metodologjia e zbatimit

Zbatimi i kësaj politike programore mbështetet në këto prioritete:

- Përkrahje materiale e klubeve, ligave të reformuara sportive në bazë të Ligjit për sport dhe akteve nënligjore të nxjerra nga MKRS në përputhje me statutet e organizatave sportive.
- Mbështetje materiale për klubet të femrave, për pjesëmarrje në aktivitet sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Mbështetje të aktiviteteve që kanë të bëjnë me masovitetin e sportit të femrave, në nivel lokal dhe nacional.
- Mbështetje materiale për reprezentacionet e femrave në grumbullim (përgatitje) para aktiviteteve ndërkombëtare.
- Mbështetje materiale në seminarët për trajner-e, gjyqtar-e dhe administrator-e të sportit (stafi profesional).
- Mbështetje materiale për projektet që mbulojnë shënimin e datave të rëndësishme kombëtare dhe manifestimet tradicionale sportive.
- Përkrahje në ri-aktivizimin e sporteve femërore.
- Mbështetje në organizimin e aktiviteteve të Kupës së Republikës së Kosovës.
- Mbështetje materiale për projektet që realizohen në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Drejtoritë komunale për sport, me shoqata jo-qeveritare, organizatat ndërkombëtare, ambasadat tona dhe ambasadat e huaja në Kosovë.

## Partnerët / Bashkëpunëtorët

Për realizimin e kësaj politike programore me qëllim të arritjes së objektivave të planifikuara, MKRS - Departamenti i Sportit do të bashkëpunojë ngushtë me Komitetin Olimpik të Kosovës, Federatat e Sportit, Drejtoritë komunale për sport, me shoqatat jo-qeveritare brenda dhe jashtë vendit.

## Financimi

Mjetet financiare të parapara për këtë politikë programore nuk janë të mjaftueshme në realizimin e të gjitha objektivave që dalin nga kjo politikë, andaj MKRS - Departamenti i sportit do të bashkëpunojë ngushtë me asociacionet tjera sportive dhe organizata tjera buxhetore.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
 Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo  
 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministry of Culture, Youth and Sports

Kufi Nr.: 316/17015  
 Data: 05.02.2015  
 Niveli i shkëlqimit: [Signature]  
 PRISHTINË, PRISTINA, PRISHTINA



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
 Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo  
 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministry of Culture, Youth and Sports

Kufi Nr.: 158/2015  
 Data: 27/01/2015  
 Niveli i shkëlqimit: [Signature]  
 PRISHTINË, PRISTINA, PRISHTINA

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
 Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport - Ministry for Culture, Youth and Sport

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO:		z.Kujtim Shala - Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit	
CC:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Veton Firzi - Sekretar i Përgjithshëm /MKRS-së	
NGA/OD/FROM:		Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit /MKRS-së	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Aprovimi i politikës programore nr.2 – Politika Programore për zhvillimin e kuadrit në Mjekësin Sportive dhe Anti Doping	
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357
Br. kancelarije:		Kucni:	
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)
		Data:	31
		Datum:	Janar
		Date:	2015

Duke iu referuar materialit të bashkëngjitur, që ka të bëjë me realizimin e politikës programore numër dy (2) - Mjekësia e sportit; kërkojmë nga zyrtarët e lartë të Ministrisë që të aprovojnë këtë politikë programore me çka do të mundësohej fillimi i punëve konkrete gjatë vitit 2015.

Ndryshimet e bëra të kësaj politike programore në krahasim me vitet e kaluara, konsistojnë në krijimin e mundësive më të mëdha për trajnimin dhe shkollimin e kuadrove të reja në lëmin e mjekësisë sportive duke kontribuar në profilizimin dhe specializimin e tyre.

Po ashtu, parashihet të ketë edhe investime në pajisje mjekësore duke punuar në drejtim të krijimit dhe funksionalizimit të sektorit anti-doping në kuadër të Qendrës së mjekësisë sportive.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën prej 70,000.00€.

z.Veton Firzi  
 Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z.Kujtim Shala  
 Ministër i MKRS-së

Ministria e kulturës rinisë dhe sportit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosova  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*  
*Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport – Ministry for Culture, Youth and Sport*

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore: MJEKËSIA E SPORTIT (Nr. 2)

### Hyrje

Çështja e mjekësisë së sportit është ngritur në nivel të prioritetit të veçantë, nga ana e Departamentit të Sportit duke pasur në konsideratë edhe trajtimin që ka ky segment në arenën ndërkombëtare, dhe si e tillë mbulon një aktivitet të domosdoshëm në drejtim të përparimit (dhe mbrojtjes) të sportit në nivele kulminante.

Kjo politikë programore, gjen aplikim të gjerë pothuaj në të gjitha nivelet e sportit, mbulon dhe siguron një rrjedhë normale të aktiviteteve sportive dhe rezultojnë me të dhëna shumë të dobishme në funksion të përmirësimit të kualiteteve fiziologjike tek sportistët.

### Historiku

Duke qenë segment shumë i rëndësishëm i sportit, në përkrahje të realizimit të kësaj politike, Departamenti i Sportit ka ndarë buxhet që nga viti 2001, përmes sigurimit të pajisjeve mjekësore për antropometri, motorike dhe rehabilitim, pajisjeve për sektorin e fiziologjisë së sportit dhe pajisjeve për anti-doping dhe laboratorin muskolor.

### Qëllimi / Objektivi

Mjekësia e sportit paraqet një standard të domosdoshëm të sportit kulmor, testimëve dhe verifikimin e sportistëve për të plotësuar kushtet e pjesëmarrjes në aktivitete sportive si dhe për të vlerësuar rezultatet e arritura sportive nëse ato kanë qenë në harmoni me rregullat dhe dispozitat të aplikueshme e të pranuar ndërkombëtarisht.

Në këtë drejtim synohet paisja e qenderes së mjekësisë së sportit. Qendrën e mjekësisë së sportit me aparaturën e nevojshme për të zyrtarizuar dhe për të bërë të obliguara kontrollimet mjekësore për të gjithë sportistët dhe klubet sportive që garojnë në kuadër të federatave të licencuara të sportit. Kjo edhe për faktin se disa federata janë të pranuar ndërkombëtarisht, me çka krijohen kushtet për pjesëmarrje më përmbajtësore në arenën ndërkombëtare dhe bëhen testet e obliguara anti-doping dhe testet tjera për garat zyrtare.

### Strategjia dhe Metodologjia e zbatimit

Zbatimi i kësaj politike programore mbështetet në këto prioritete:

- Ngritja e kuadrit mjekësor për të kryer kontrollet dhe testimet standarde për vlerësimin e aftësive lëvizore dhe funksionale. (Ne bashkpunim me Ministrin e Shëndetësisë)
- Sigurimi i pajisjeve / aparaturës mjekësore për qendrën e mjekësisë sportive;
- Trajnimi i kuadrit profesional për punë në Qendrën e mjekësisë sportive.
- Mbeshtetja e seminareve të mjekësisë sportive me pjesëmarrjen e mjekëve sportivë aktual të sportit dhe mjekëve që synojnë të profilizohen dhe specializohen në mjekësinë e sportit.
- Mbeshtetje iniciativave për krijimin e qendrave regjionale të Mjekësisë Sportive.

### Partnerët / Bashkëpunëtorët

Për realizimin e programit të planifikuar do të shfrytëzohen fondet e mundshme nga MKRS-Departamenti i Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Komiteti Olimpik i Kosovës (organizata WADA, ANADA etj.) Fakulteti i Shkencave Sportive dhe Drejtoritë Komunale për Sport.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	z.Kujtim Shala - Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Veton Firzi - Sekretar i Përgjithshëm /MKRS-së				
NGA/OD/FROM:	Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit /MKRS-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aprovimi i politikës programore nr. 3 – Politika Programore të avancimit të sportit cilësor				
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357	Data:	31
Br. kancelarije:		Kucni:		Datumë:	janar
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)	Date:	2015

Politika programore propozohet në tërësi edhe këtë vit me disa ndryshime të cilat janë në interes të sportit.

- Për kampe në nivel të federatave nuk do të jetë e kufizuar koha e mbajtjes së kampeve, me qëllim që ato kampe të jenë në njëfarë forme edhe si faza përgatitore para ndonjë aktiviteti të rëndësishëm sportiv;
- Me kërkesën e federatave do të ju mundësohet që deri në një shkallë të caktuar të angazhojnë edhe (senior) kur është në pyetje reprezentacioni.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën 210,000.00 €.

z.Veton Firzi  
Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z.Kujtim Shala  
Ministër i MKRS-së

Ministria e kulturës rinisë dhe sportit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore:(3)

PROGRAMI PËR AVANSIMIN E SPORTIT E TE RINJVE

#### Historiku

Programi për zhvillimin e të rinjve, respektivisht kampet përgatitore janë treguar shumë të suksesshme gjatë viteve të kaluara. Kjo më së miri mund të vërehet nga numri i klubeve të krijuara pas aktiviteteve të kampet përgatitore, çka nënkupton një rezultat të drejtpërdrejtë në stimulimin dhe avancimin e sportit kosovar.

MKRS-Departamenti i Sportit realizon këtë politikë programore që nga viti 2000 me plot sukses dhe te arritura konkrete.

#### Qëllimi / Objektivi

Duke qenë të bindur se potenciali ( dhe fuqia e ) vërtetë e sportit të Kosovës qëndron tek të rinjtë, është hartuar edhe kjo politikë programore në mbështetje të federatave të sportit për zhvillimin dhe avancimin e kualiteteve të sportistëve të rinj dhe të talentuar.

Për të siguruar më shumë mundësi për trajnime profesionale dhe për të përmirësuar nivelin e sportit në Kosovë.

Departamenti i Sportit - MKRS planifikon të përkrahë federatat e sportit në organizimin dhe mbajtjen e kampeve: identifikimi, seleksionimi dhe avancimi në nivel të reprezentacioneve.

Grumbullimet për të rinje kanë për objektiv ngritjen e nivelit të sportit, njëkohësisht edhe ngritjen e nivelit të udhëheqjes profesionale të procesit stërvitor në sport.

MKRS - Departamenti i sportit në bazë të buxhetit do të mbështet ligat e grupmoshave (kadet, junior) në bashkpunim me federatat përkatëse.

#### Metodologjia e zbatimit



Kampet (seleksionimi) do të organizohen dhe zbatohen nga federatat e sportit, ndërsa bashkë-financimi do të bëhet nga Departamenti i sportit - MKRS dhe Federatat e Sportit. Kampet do të ndihmohen në nivel kombëtar, ndërkombëtarë dhe shpresave olimpikë.

- Mbështetje materiale për përgatitje profesionale të reprezentacioneve brenda dhe jashtë vendi,
- Mbështetje e talenteve të rinj në përgatitje profesionale me propozim nga federatat - KOK-u.
- Mbështetje materiale për seleksionet e regjioneve - rajoneve të caktuar, për aktivitete dhe gara të caktuara nderkombëtare, në bashkëfinancim me komunat e Kosovës.
- Mbështetje me rekuizita të caktura reprezentacionet e të rinjeve.
- Mbështetje federatave në ngritjen e kuadrave profesional të dalur nga grupmoshat e reja (refer, trajner, administrator etj.).

### Monitorimi

Monitorimi i punës dhe aktivitetit që zhvillohet në kuadër të kampeve do të bëhet nga menaxherët e sportit, pavarësisht vendit ku mbahen ato - brenda apo jashtë vendit.



### Kalendari i kampeve

Kampet mund të mbahen në kohë të përshtatshme dhe të dobishme për federatën e sportit e cila organizon kampin në bazë të programit të aktiviteteve vjetore.

Në raste të veçanta, ekipet e seniorëve do të mund të gjejnë përkrahje për të zhvilluar takime të rëndësishme të veçantë.

### Financimi

Financimi dhe realizimi i projekteve të kampeve do të bëhet nga departamenti i sportit - MKRS në bashkëfinancim me federatat e sportit, KOK-un, Kuvendet gjegjëse komunale dhe donatorët e mundshëm (organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare).



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	z.Kujtim Shala - Ministër i Kulturës ,Rinisë dhe Sportit				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Veton Firzi - Sekretar i Përgjithshëm / MKRS-së				
NGA/OD/FROM:	Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit /MKRS-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aprovimi i politikës programore nr. 4 <b>Politika Programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive të karakterit ndërkombëtar jashtë vendit</b>				
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357	Data:	
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	janar
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)	Date:	2015



Këtij dokumenti i është bashkangjitur politika programore numër katër (4) që mbulon programin e departamentit të sportit për zhvillimin e aktiviteteve sportive të karakterit ndërkombëtar jashtë vendit. Në parim, nuk parashihen ndryshime të theksuara krahasuar me politikën e njëjtë programore nga viti i kaluar.

Këtë vit presim një aktivitet edhe më të dendur të garave dhe aktiviteteve sportive të karakterit ndërkombëtar, duke marrë parasysh fazën në të cilën gjendet sporti i Kosovës dhe angazhimet e federatave për të zyrtarizuar aktivitetin e tyre në rrafshin ndërkombëtar.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën prej 600,000.00€.

z.Veton Firzi  
Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z.Kujtim Shala  
Ministër i MKRS-së

Ministria e kulturës rinisë dhe sportit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore: (4) **PJESEMARRJA NE GARA NDËRKOMBËTARE TE SPORTIT**

### Hyrje

Politika programore e aktiviteteve sportive të karakterit ndërkombëtar paraqet programin më të rëndësishëm në plan-programet e hartuara të departamentit të sportit - MKRS.

Duke pas parasysh faktin se sporti i Kosovës ka qenë i mbyllur dekadat e fundit, rezultojnë dhe janë evidente pasojat në drejtim të avancimit të kualitetit dhe prezantimit të vlerave sportive e kombëtare jashtë vendit.

Nga viti 2001, vazhdon t'u jepet një përkrahje më të madhe të aktiviteteve sportive ndërkombëtare, ndërsa këtë vit kërkon ende përkrahje duke konsideruar faktin se tanimë po rriten mundësitë për prezantim jashtë vendit.

### Qëllimi / Objektivi

Kjo politikë programore rregullon mënyrën e financimit të aktiviteteve sportive ndërkombëtare, kategoritë e aktiviteteve sportive ndërkombëtare që do të financohen. Prioritetet e garave dhe aktiviteteve tjera ndërkombëtare, mënyrën e paraqitjes së kërkesës ( aplikimit) për përkrahje materiale, personat zyrtar që udhëtojnë me sportistë, forma e transportit, kategorizimi i akomodimit dhe shpenzimet që do të mund të mbulojë MKRS - Departamenti i sportit

#### 1. Kategoritë e aktiviteteve sportive ndërkombëtare

- Garat ndërkombëtare
- Seminar Ndërkombëtarë
- Përvojat ndërkombëtare.

#### 2. Prioritetet për financim të garave dhe aktiviteteve tjera ndërkombëtare

Garat ndërkombëtare:

- Lojërat Olimpikë

- Kampionatet Botërore, Evropiane, Mesdhetare dhe Ballkanike;
- Kupat Botërore, Evropiane, Mesdhetare dhe Ballkanike;
- Turne zyrtare ndërkombëtare të kategorive junior dhe senior;
- Turne mbarëkombëtare të karakterit tradicional.

Seminaret ndërkombëtare:

- Seminaret për trajner;
- Seminaret për gjyqtar sportiv;
- Seminaret për garues / lojtarë;
- Seminaret për menaxher dhe administrator të sportit;

Lobimi / përvojat ndërkombëtare:

- Pjesëmarrja në punime të asambleve sportive ndërkombëtare;
- Kontaktet me personalitete të larta sportive me qëllim ndërkombëtarizimin të sportit;
- Shkëmbimi i përvojave dhe ekspertëve përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit.

### 3. Mënyra e paraqitjes së kërkesës për mjete financiare

Kërkesës për mbështetje financiare duhet t'i bashkëngjitet ftesa për pjesëmarrje në aktivitete / gara ndërkombëtare. Kërkesa duhet të dorëzohet për shqyrtim në departamentin e sportit së paku 20 ditë para nisjes dhe duhet të përmbajë këto të dhëna:

- Shënimet personale dhe nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës zyrtare (emri, mbiemri, funksioni, nënshkrimi dhe vula zyrtare).
- Shënimet për organizatorin, vendin, kohëzgjatjen dhe karakterin e garës.
- Numrin e sportistëve pjesëmarrës, me të gjitha shënimet personale.
- Numrin e personave zyrtarë, me të gjitha shënimet personale.
- Formën e transportit dhe çmimin.
- Paraqitja për pjesëmarrje në gara dhe çmimi për gara individuale dhe ekipore;
- Akomodimi (vendosja dhe ushqimi – kategoria e hotelit), çmimi;
- Shpenzimet tjera (taksa për nxjerrjen e vizave, uniforma për reprezentuesit, ushqimi gjatë rrugës, flamujt dhe shenjat tjera të sportit përkatës);
- Shuma e përgjithshme e projektit – Totali.

### 4. Numri i sportistëve pjesëmarrës dhe personave zyrtarë

Numri i sportistëve pjesëmarrës përcaktohet nga Federata e sportit përkatës që bën organizimin, duke u bazuar në kriteret e aprovuara ndërkombëtarisht, nga federatat ndërkombëtare.

Persona zyrtar, që shoqërojnë delegacionin sportive, mund të jenë: udhëheqësi i rrugës, trajneri / selektori dhe stafi teknik (profesional), mjeku / fizioterapeuti dhe gjyqtari.

### 5. Lloji i transportit

Delegacionet sportive, për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare mund të udhëtojnë me:

- aeroplanë (për distanca të mëdha, kategoria ekonomike);
- autobusë (për distanca deri në 1,000 km), dhe
- automjete personale (për distanca të vogla – shtetet fqinje në regjion).

## 6. Kategoria e hotelit

Sportistët dhe personat zyrtar mund të vendosen ne hotelet, motelet dhe akomodimet tjera që bijën në kategorinë e tretë (tre yje), nëse organizatori nuk e përcakton ndryshe akomodimin.

## 7. Prioritetet për mbështetje financiare

Në mbështetjen materiale të projekteve, prioritet do të kenë:

- transporti (biletat e aeroplanit, autobusit apo mjeteve tjera transportuese);
- pagesa për pjesëmarrje në gara (individuale dhe ekipore);
- akomodimi (vendosja dhe ushqimi);
- shpenzimet tjera (taksa për nxjerrjen e vizave, uniforma për reprezentuesit, ushqimi gjatë rrugës, flamujt dhe shenjat tjera të sportit përkatës).

## 8. Lloji i shpenzimeve që mbulon departamenti i sportit

Varësisht nga kategoria dhe rëndësia e garës, respektivisht aktivitetit ndërkombëtar, departamenti i sportit do të vendosë nëse do të mbështetet projekti apo aktiviteti sportiv, dhe do të caktojë se cilat shpenzime do të mbulojë.

Departamenti i sportit mund të vendosë që të shpërblejë fituesit e medaljeve nga arena ndërkombëtare me bursa studimi dhe forma tjera të stimulimit (është e propozuar në Ligjin për Sport).

## 9. Bashkëpunëtorët

Në realizimin e projekteve për pjesëmarrje në garat sportive ndërkombëtare, bashkëpunëtorë të drejtpërdrejtë të departamentit të sportit - MKRS do të jenë KOK-u, Federatat e sportit, Fakulteti i Shkencave Sportive dhe donatorëve tjerë.

## 10. Fondet

Projektet që do të realizohen në kuadër të kësaj politike programore do të përkrahen nga buxheti i MKRS - Departamentit të sportit, nga mjetet e federatave të sportit, ambasadat e huaja dhe nga donatorët.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	z.Kujtim Shala – Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Veton Firzi - Sekretar i Përgjithshëm /MKRS-së
NGA/OD/FROM:	Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit /MKRS-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aprovimi i politikës programore nr. 5 – Politika Programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive të karakterit ndërkombëtar brenda vendit
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	27
Lokacioni: Kucni: Extension:	038/211 357 22 021 (centrex)
Data: Datum: Date:	31.01.2015 janar 2015

Dokumentit i është bashkangjitur politika programore numër pesë (5) që mbulon programin e departamentit të sportit për zhvillimin e aktiviteteve sportive të karakterit ndërkombëtar brenda vendit. Do të ketë një rritje të vogël në aspektin e përkrahjes materiale të kësaj politike, ndërsa që nuk parashihen ndryshime të theksuara sa i takon përmbajtjes dhe metodologjisë së zbatimit.

Duke pas parasysh se kjo politikë programore është ngushtë e lidhur me politikën numër katër (4), pritet edhe këtu një rritje në përmbajtje dhe cilësi të aktiviteteve sportive në Kosovë që lidhen me ndërkombëtarizimin e sportit.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumë prej 200,000.00€.

z.Veton Firzi  
Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z.Kujtim Shala  
Ministër i MKRS-së



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore: (5) AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TE SPORTIT NË KOSOVË

### Hyrje

Kjo politikë është e rëndësishë së veçantë për avancimin e sportit, organizimin e ngjarjeve të ndryshme sportive si dhe për afirmimin e vlerave sportive dhe kombëtare.

Për një kohë të gjatë në Kosovë kanë munguar aktivitetet ndërkombëtare, kështu që është krijuar një vakum sa i takon organizimit të ngjarjeve të rëndësishme me karakter ndërkombëtar dhe mundësisë për të prezantuar kualitetet sportive jashtë vendit, me çka do të ndikohet pozitivisht edhe në avancimin e përgjithshëm të sportit vendor.

### Qëllimi / Objektivi

Qëllimi i MKRS - departamentit të sportit është të ndihmojë organizimin e garave ndërkombëtare në Kosovë të cilat do të ndikojnë në:

- Ngritjen e nivelit të sportit në Kosovë;
- Afirmimi i shtetit dhe kulturës sportive;
- Stimulimin e sportistëve që të jenë aktiv në sport dhe të punojnë në avancimin e mëtejshëm të sportit.
- Përkrahja e federatave për organizimin e ngjarjeve me karakter ndërkombëtar;

Përveç të mirave që sjell realizimi i këtij objektivi për sportin e Kosovës duhet cekur anët pozitive që sjell për shoqërinë dhe afirmimin e përgjithshëm .

## Strategjia e zbatimit

Mënyra se si do të realizohen projektet që bijën në kuadër të kësaj politike programore, varet nga rangimi për kah rëndësia dhe hierarkia e garave, duke nisur nga karakteri i lojërave prej atyre olimpike e deri te garat me karakter miqësor.

MKRS - departamenti i sportit – do të ndihmojë federatat e sportit dhe KOK-un në këto segmente:

- Përkrahja material për zhvillimin e garave zyrtare sipas kalendarit të federatave ndërkombëtare;
- Përkrahja materiale federatave sportive dhe ekipeve sportive që marrin pjesë në garat sportive me ftesë zyrtare nga federatat kombëtare përkatëse, përmes mbulimit të shpenzimeve për akomodim (fjetje dhe ushqim);
- Mbulimin e shpenzimeve për transportin lokal, gjatë kohës sa zhvillohen aktivitetet sportive;
- Sipas buxhetit, do të ofrohet përkrahje dhe asistencë teknike, qoftë me pajisje teknike apo edhe rekuizita të nevojshme sportive.

## Metodologjia e zbatimit

Aplikuesit për realizimin e përkrahjes materiale për gara ndërkombëtare në Kosovë duhet të përfillin formën dhe kriteret vijuese:

- Duhet të sjellin të dhënat e plota për karakterin dhe specifikat e garës (vendi ku mbahet, kohëzgjatja, natyra e garës, etj);
- Numri i ekipeve apo sportistëve pjesëmarrës në garë dhe informacionet themelore për reprezentacionin/et dhe ekipin/et që do të marrin pjesë;
- Numri i zyrtarëve që udhëtojnë me ekip – nëse flitet për zyrtarë të klubit apo të rëndësisë së veçantë (kur përfaqësohen edhe institucione tjera të sportit);
- Verifikimi i kërkesave të ardhura nga federatat e sportit rreth vendosjes së sportistëve në hotel si dhe për transportin lokal.

## Partnerët / Bashkëpunëtorët

Për realizimin e kësaj politike programore, MKRS - departamenti i sportit do të bashkëpunoj me Komitetin Olimpik të Kosovës, Federatat e sportit (përmes kontributeve të veta dhe sponsorizimit të jashtëm), Ambasadat diplomatike të vendosura në Kosovë dhe shoqatat e ndryshme jo-qeveritare lokale apo të huaja që veprojnë në Kosovë.

## Financimi

Projektet që do të realizohen në kuadër të kësaj politike programore do të përkrahen nga buxheti i MKRS - Departamentit të sportit, nga mjetet e federatave të sportit, ambasadat e huaja dhe nga donatorët.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	z.Kujtim Shala - Ministër i Kulturës ,Rinisë dhe Sportit				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Veton Firzi - Sekretar i përgjithshëm /MKRS-së				
NGA/OD/FROM:	Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit /MKRS-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aprovimi i politikës programore nr. 6 – Politika Programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive për minoritetet dhe sportin multietnikë				
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357	Data:	31
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	janar
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)	Date:	2015

Dokumentit i është bashkangjitur politika programore numër gjashtë (6) që mbulon programin e departamentit të sportit për zhvillimin e aktiviteteve sportive për minoritetet dhe sportin ndëretnik.

Do të ketë përkrahje të njëjtë me atë që kishim vitin e kaluar për sportin e minoriteteve dhe sportin ndëretnik, dhe do të ndihmohet në përfshirjen e minoriteteve në strukturat shoqërore, në përmirësimin e kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive, në promovimin e aktiviteteve të përbashkëta sportive dhe komunikimin e vazhdueshëm e të lirë ndëretnike.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën prej 100,000.00 €.

z. Veton Firzi  
Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z. Kujtim Shala  
Ministër MKRS-së



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore: (6) SPORTI I MINORITETEVE DHE NDËRETNIK

#### Historiku

Politika programore e sportit multietnik dhe minoriteteve ka për qëllim masivizimin, zhvillimin, avancimin dhe përfshirjen e sportit ndëretnik dhe minoritar në kuadër të federatave të licencuara të sportit të Kosovës.

Departamenti i sportit - MKRS i ka kushtuar rendësi të veçantë kësaj politike programore.

Përveç mbështetjes që i bëhet sportit minoritar dhe atij multietnik nga kjo politikë programore, përkrahje me projekte ofrohet edhe nga politikat tjera programore.

#### Qëllimi / Objektivi

Përmes kësaj politike programore, MKRS - departamenti i sportit synon të arrijë këto qëllime:

- Përfshirja e minoriteteve në institucionet të licencuara të sportit të Kosovës;
- Hartimi dhe promovimi i programeve dhe përkrahja e institucioneve të cilat ndihmojnë realizimin e qëllimit të pare;
- Inkurajimi i komunikimit me të gjitha komunitetet e Kosovës;
- Investimet në përmirësimin e pajisjeve, infrastrukturës, zhvillimit të aftësive menaxhuese, aktivitetet sportive dhe institucionet e minoriteteve;
- Promovimi i sportit shkollorë në komunat e banuara me minoritete.

#### Metodologjia e zbatimit

Me qëllim të arritjes së objektivave të planifikuara, kjo politikë programore parasheh:

- Krijimin e raporteve më të mira të komunikimit me komunitetin sportive të minoriteteve, për të dëgjuar brengat e tyre përmes drejtorive komunale për sport, MKRS - departamentit të sportit dhe zyrave komunale për minoritete;

- Krijimi i programeve të reja dhe përkrahja e atyre ekzistuese nëpër zonat e banuara me minoritete me qëllim të zhvillimit të sportistëve që premtojnë dhe gjithashtu të ndihmohen aktivitetet sportive tek të rinjtë.
- Në mënyrë të vazhdueshme të inkurajohet formimi i klubeve të reja dhe stimulimi i programeve të lartpërmendura që do të zbatoheshin me qëllim të forcimit të komunikimit mes klubeve sportive në kuadër të ligave;
- Stimulimi i klubeve sportive të organizuara në mënyrë legjitime ose garave ekipore.
- Promovimi i aktiviteteve sportive tek fëmijët me qëllim të përhapjes së aktiviteteve sportive për të gjitha moshat.

#### Partnerët / Bashkëpunëtorët

MKRS-Departamenti I sportit,  
 KOK-u, Federatat e sportit , klubet  
 Drejtoritë komunale për sport;  
 Organizatat Jo-Qeveritare vendore dhe ato ndërkombëtare, dhe  
 Ambasadat e shteteve qe jane prezente ne Kosove.

#### Financimi

Projektet që plotësojnë kriteret dhe qëllimet e lartshënuara do të kenë përkrahjen financiare për realizim nga MKRS - departamenti i sportit.  
 Kjo përkrahje do të ndryshojë varësisht nga rëndësia e projektit dhe gjendja financiare – kapacitetet buxhetore të MKRS-departamentit të sportit.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
 Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo  
 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministry of Culture, Youth and Sports  
 Ref. Nr. 313 / 2015  
 Data 05.02.2015  
 Nënshkrimi  
 Pristina, Prishtina, Prishtina



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
 Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo  
 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Ministry of Culture, Youth and Sports  
 153/2015  
 27/01/2015  
 Pristina, Prishtina, Prishtina

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosova  
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
 Ministarstvo za Kultururu, Omladinu i Sport - Ministry for Culture, Youth and Sport

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO:		z.Kujtim Shala - Ministër i Kulturës ,Rinisë dhe Sportit	
CC:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:		Veton Firzi - Sekretarë i Përgjithshëm / MKRS-së	
NGA/OD/FROM:		Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit /MKRS-së	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Aprovimi i politikës programore nr. 7 - Infrastruktura e Sportit dhe Rekuizitat Sportive	
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357
Br. kancelarije:		Kucni:	
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)
		Data:	27 Janar 2015



Duke iu referuar materialit të bashkëngjitur, që ka të bëjë me realizimin e politikës programore numër shtatë (7) - Infrastruktura e sportit dhe rekuizitat e sportit, kërkojmë nga zyrtarët e lartë të Ministrisë që të aprovojnë këtë politikë programore me çka do të mundësohej edhe fillimi i punës për realizimin e saj gjatë vitit 2011.

Ndryshimet e bëra të kësaj politike programore në krahasim me vitet e kaluara, konsistojnë në faktin se në vitin 2011 duhet të vazhdojnë punët e mbetura nga viti i kaluar, ndërsa që do të punohet edhe në rinovimet e nevojshme në objektet e rëndësishë së veçantë për sportin kualitativ.

Ajo që mbetet e njëjtë me politikën e vitit të kaluar është e dhëna se pajisje të palestrave të sportit të vazhdojnë të trajtohen në kuadër të së njëjtës politikë programore sipas mundësive buxhetore.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën prej 8,198,684.00€.

z. Veton Firzi  
 Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z. Kujtim Shala  
 Ministër i MKRS-së



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*  
*Ministarstvo za Kulturu, Omladinu i Sport - Ministry for Culture, Youth and Sport*

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

Politika Programore: (7) INFRASTRUKTURA E SPORTIT

Aneksi: (7.1) REKUIZITAT E SPORTIT

### Hyrje

Infrastruktura sportive është kushti themelor për përmirësimin e kualitetit të aktiviteteve sportive si dhe ngritjen e sportit në nivelin e standardeve të pranueshme ndërkombëtare.

Me gjithë ndërhyrjet dhe investimet që janë bërë nga MKRS - Departamenti i sportit viteve të fundit, gjendja e infrastrukturës së sportit mbetet akoma larg nivelit të dëshiruar.

Ngritja e kualitetit të sportit në Kosovë shkon gjithsesi me përmirësimin e objekteve sportive.

Ky përmirësim i kualitetit të sportit mund të arrihet me ndërtimin e infrastrukturës së re, rinovimin dhe modernizimin e infrastrukturës ekzistuese sportive.

### Qëllimi / Objektivi

Qëllimi / objektivi i kësaj politike është përmirësimi i infrastrukturës sportive, modernizimi si dhe krijimi i mundësive për ndërtimin e infrastrukturës së re të sportit në Kosovë.

Ky do të ishte edhe kusht për ngritjen e cilësisë së sportit dhe krahas kësaj krijimin e mundësive për të ndihmuar sportistët kosovar të jenë të barabartë në garat ndërkombëtare.

### Historiku

Vitet e fundit, MKRS - Departamenti i Sportit, duke i prezantuar programet e veta për renovime të vogla, ka kontribuar drejtpërdrejt në riparimin e objekteve sportive në shumicën e rajoneve të Kosovës. Kjo është bërë për arsye se një numër mjaft i madh i objekteve sportive në gjithë Kosovën ishin në gjendje jo të mirë dhe pas rehabilitimeve të vogla ato tani përdoren për aktivitete të ndryshme sportive.

Në vazhdimësi, MKRS - Departamenti i Sportit ka bashkëpunuar me disa komuna dhe i ka mbështetur projektet e tyre me mjete për ato komuna që kanë në mungesë të buxhetit komunal deri në 100% ku komunat nuk kanë disponuar me mjete materiale nga fondi komunal, ka projekte të përbashkëta me Komisionin Evropian (IPA) dhe donatorët tjerë.

## Politika programore 2014

Për vitin 2013, politika programore e infrastrukturës së sportit do të koncentrohet në investime më të mëdha të cilat do të mbulojnë komunat si ne objekte e mbyllura ashtu edhe te hapura në komuna përkatëse.

Është planifikuar të shkohet në investime të reja, respektivisht vazhdimin e ndërtimit të palestrave sportive të filluara nga viti paraprake siq janë: Drenasi, Istogu, Rahovec, Obiliq, Shtimja, Deçani , Skenderaj,Dardana,Klina,Kaçanik,inicimi për Ndertimin e Palestres në Viti dhe Dragashdhe Sallave te Edukates Fizike në Samadrexhe te Vushtrise,Zheger te Gjilanit po ashtu Ndertimi i Pallatit Olimpik në Komunene e Prishtines ,Ndertimi i terreneve te Tenisit në Komunën e Gjakovës dhe Pejesë.

Vazhdimi i projektit multifunksional për sport në bashkfinancim me Komisionin Evropian (IPA) në Qytetin e Mitrovicës.

Rinovimi i disa prej objekteve ekzistuese si në Palestra te Sportit ne qendrat regjionale në Komunat sipas kerkesave, Renovimi i Stadiumeve në Qendrat Regjionale, inicimi për Ndertimin e dy Fushave Ndihmese te Futbollit në Komunen,Prizrenit,Istogut,Renovimi dhe Sanimi I Stadiumit te Prishtinë.

Ndertimi i Poligoneve Sportive,Renovimi i Shtigjeve te Atletikës në Stadiumin „Adem Jashari“ në Mitrovicë, me qëllim të funksionalizimit te tyre dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e garave me karakter kombëtarë dhe ndërkombëtarë

Në këtë Politikë programore, investimet në infrastruktura do të koncentrohen në realizimin më të mëdha të projekteve ku Komunat e Republikës së Kosovës janë perfituese.

## Strategjia dhe Metodologjia e zbatimit

- Kërkesat për objekte të reja të infrastrukturës së sportit pranohen nga drejtoritë komunale përkatëse per sport, ku protokoloohen dhe të njëjtat shqyrtohen sipas planifikimeve buxhetor te MKRS.
- MKRS - Departamenti i sportit ne afatet ligjore ndjeke procedurat: dokumentacionin teknik te projektit; afatet kohore, etj, dhe në vazhdimësi ben perpjekje qe te përmirësojë dhe korrigjojë mangësitë e konstatuara në projektet përkatëse,duke paraqitur vështirësitë dhe problemet të cilat jane shfaqur në kryerjen e punëve ndërtimore;
- Projektet e aprovuara nga MKRS harmonizohen me perfituesit e projekteve si ne bashkë-financim , po ashtu edhe ne realizimin e projektit sipas standardeve te ndertimit;

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të kësaj politike programore kërkohet që të inicohet procedure urgjente në definimin e pronës të infrastructures në nivel komunal dhe shtetrorë.

## Partnerët / Bashkëpunëtorët

Komunat do të jenë partner të drejtpërdrejt në realizimin buxhetor të kësaj politike programore. MKRS - Departamenti i sportit do të bashkëpunoj ngusht me Ministrinë e Insrastrukturës, Arsimit, Shëndetësisë, Pushtetit Lokal, Ministrinë e Kthimit Tregtisë dhe Industrisë, Agjensionin Evropian për

Rindërtim IPA, Bankën Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim, Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Federatat e sporteve.

## Aneksi i politikës programore të infrastrukturës së sportit – Rekuizitat sportive

### 7.1 Rekuizitat sportive

Cilësia momentale e infrastrukturës dhe rekuizitave/pajisjeve sportive po rezulton me ngecjen e nivelit të sportit në Kosovë. Pajisjet adekuate sportive mungojnë në përgjithësi ose janë në gjendje të dobët dhe të kualitetit që nuk plotëson standardet e kërkuara për zhvillimin e ndeshjeve / garave ndërkombëtare. Rritja e cilësisë së sportit shkon krahas me përmirësimin e objekteve dhe pajisjeve sportive në Kosovë.

#### Qëllimi

Qëllimi kryesor i kësaj politike programore është që të ndikojë në modernizimin e objekteve sportive me mjete të cilat do t'i përshtaten standardeve të sportit cilësor.

Kjo politikë programore (bashkë me aneksin), në kombinim me politikat tjera zhvillimore të sportit me kohë do të japin fryte në rritjen e cilësisë së sportit në Kosovë dhe do të kontribuojnë që sportistët Kosovar të ngritën profesionalisht.

#### Historiku


Deri tani departamenti i sportit ka punuar në masivizimin e sportit të Kosovës me disa programe të posaçme, si ato të rehabilitimeve të vogla, mirëpo duke e parë se sporti ka marrë një hov të zhvillimit të shpejtë, është nevojë e kohës që të ndikohet me programe të tjera të cilat shkojnë në drejtim të ngritjes së cilësisë së sportit dhe afrimit të standardeve ndërkombëtare.

#### Strategjia dhe metodologjia e implementimit / zbatimit

- Mbështetje e drejtorive komunale të projekteve për pajisjeve sportive me ndihmën e të cilave ndikohet në modernizimin e objekteve sportive;
- Mbështetje e federatave të sportit për projektet të cilat do të përfshijnë nevojat themelore të rekuizitave (grupore) për zhvillimin e sportit cilësor;

#### Partnerët / bashkëpunëtorët

MKRS - Departamenti i sportit do të implementojë këtë politikë programore me ndihmën e partnerëve, si janë: KOK-u, Komunat, Federatat e sportit, klubet sportive.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	z.Kujtim Shala – Ministër i Kulturës ,Rinisë dhe Sportit				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Veton Firzi – Sekretarë i Përgjithshëm / MKRS-së				
NGA/OD/FROM:	Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit/MKRS-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aprovimi i politikës programore nr. 8 –Politika Programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive për personat me aftësi të kufizuara				
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357	Data:	
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	janar
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)	Date:	2015

Këtij dokumenti i është bashkangjitur politika programore numër tetë (8) që mbulon programin e departamentit të sportit për zhvillimin e aktiviteteve sportive për njerëzit me aftësi të kufizuara.

Është planifikuar të jepet një mbështetje më e madhe për projektet që mbulojnë aktivitetet sportive të kësaj kategorie të njerëzve me shumë probleme dhe vështirësi edhe të natyrës së përfshirjes në shoqëri. Një përkrahje më e madhe shkon edhe në drejtim të përkrahjes së aktiviteteve të shoqatave që mbulojnë aktivitetin e njerëzve me aftësi të kufizuara, me qëllimin që të përmbliidhen aktivitetet e përgjithshme në kuadër të një federate të mundshme – e cila do të përkujdeset për aktivitetet sportive.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën prej 130,000.00 €.

z.Veton Firzi

Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z.Kujtim Shala

Ministër i MKRS-së

Ministria e kulturës rinisë dhe sportit





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore: (8) SPORTI I PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR

### Hyrje

Për të siguruar që të gjitha shtresat e popullsisë në Kosovë, përmes aktiviteteve sportive, të ndjehen të barabartë në shoqëri, është aprovuar politika programore për mbështetje të aktiviteteve sportive për kategorinë e njerëzve me aftësi të kufizuara .

Nga viti 2003 kjo kategori e shoqërisë është përkrahur me projekte për aktivitete sportive nga institucionet dhe shoqata të ndryshme.

Për shkak të vështirësive të përditshme me të cilat ballafaqohen njerëzit me aftësi të kufizuara, është detyrë e departamentit të sportit që të bëjë hapat e nevojshëm drejt përfshirjes më përmbytësore të popullatës së personave me aftësi të kufizuara Kosovare në sport, integritet me çka përmirësohet edhe inkuadrimi i tyre në shoqëri.

Departamenti i sportit ka kontribuar në vënien e themeleve për formimin e federatës së sportit për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe ka përkrahur një sërë projektesh si:

turne në sporte të ndryshme; rekuizita sportive (specifike për këtë kategori); pjesëmarrja në gjysmë maratonën e Prishtinës; rekuizita grupore për shkollën speciale në Pejë; pjesëmarrja në Olimpiadën speciale në Irlandë; bashkëpunimi me shoqata dhe organizata të nivelit ndërkombëtar dhe organizimi i seminarit me pjesëmarrjen e ekspertëve nga jashtë, si dhe mbështetje për Komitetin paraolimpik të Kosovës.

### Qëllimi / Objektivi

Politika programore e sportit për persona me aftësi të kufizuara synon të arrijë:

- Inkurajimin e marrjes me aktivitete sportive, masivizimin përmes programeve sportive specifike dhe të përshtatura për këtë kategori;
- Përkrahjen e aktiviteteve sportive, trajnimin dhe zhvillimin e sportistëve, duke krijuar kushte për gara;
- Lehtësimin e qasjes në objektet sportive .
- Organizimin e programeve për zhvillimin e resurseve njerëzore në administrim, trajnim dhe zhvillim të kësaj kategorie.

- Mbeshtetje materiale dhe profesionale ne bashkpunim me Federatat e sportit, per themelimin e ligave nacionale, per personate me aftesi te kufizuara.

#### Strategjia dhe Metodologjia e zbatimit

Metodologjia e realizimit të politikës programore për sportin e personave me aftësi të kufizuar mbështetet në këto prioritete:

- Inkurajimi i iniciativave prej klubeve lokale deri në nivel të federatave të sportit për organizimin e aktiviteteve sportive;
- Krijimi I Federatave përkatëse të sportit për persona më aftësi të kufizuara, për të ngritur organizimin e këtij sporti në nivel të Komitetit Paraolimpik.
- Përkrahjen materiale për aktivitetet që kanë për qëllim përfshirjen, inkurajimin dhe masivizimin e sportit për persona me nevoja të veçanta.
- Organizimin e seminareve për zhvillimin e aftësive menaxhuese me ekspertë të kësaj lëmie specifike;
- Motivimin dhe ndikimin në respektimin e standardeve të pranueshme ndërkombëtarisht sa i takon qasjes në objektet sportive për njerëzit me aftësi të kufizuara.

#### Partnerët / Bashkëpunëtorët

Me qëllim që të realizohet gjithë ajo që është planifikuar brenda kësaj politike programore, MKRS-departamenti i sportit do të bashkëpunojë me Komitetin Olimpik të Kosovës, Komiteti Paraolimpik, Federatat e sportit (përmes tyre edhe me klubet), drejtoritë komunale për sport, Ambasadat e huaja, shoqatat tjera qeveritare dhe jo-qeveritare.

#### Financimi

Financimin e prioriteteve të caktuara do t'a bëjë MKRS-departamenti i sportit dhe do të ndihmojë në organizimin e aktiviteteve në përgjithësi.

Do të mund të realizohen edhe projektet që bashkë-financohen nga komunat, KOK-u, Komiteti paraolimpik federatat, Ambasadat e huaja, shoqatat qeveritare e jo-qeveritare.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	z.Kujtim Shala - Ministër i Kulturës ,Rinisë dhe Sportit				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Veton Firzi - Sekretarë i Përgjithshëm /MKRS-së				
NGA/OD/FROM:	Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit /MKRS-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aprovimi i politikës programore nr. 9 – Politika Programore për zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Federatave të sportit				
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357	Data:	31
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	janar
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)	Date:	2015

Dokumentit i është bashkangjitur politika programore numër nëntë (9) që mbulon programin e departamentit të sportit për zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Federatave të sportit.

Është paraparë një ngritje materiale për mbështetjen e aktiviteteve dhe seminareve që organizohen në nivel të federatave të sportit me qëllim të ngritjes së nivelit administrativ, teknik, me qëllim që të jenë të përgatitura për bashkëpunim dhe bashkëveprim me organizmat gjegjëse të rrafshit ndërkombëtar.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën prej 180,000.00 €.

z.Veton Firzi  
Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z.Kujtim Shala  
Ministër i MKRS-së



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore: (9) ZHVILLIMI I AFTËSIVE MENAGJUESE NË  
FEDERATA

### Hyrje

Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese është një nga qëllimet dhe parimet më të rëndësishme të punës që bën departamenti i sportit në drejtim të zhvillimit të institucioneve të sportit në Kosovë.

Periudhat e mëhershme të punës diskriminuese patën rezultuar me rrënimin e shumë institucioneve - ndër të tjerat edhe të atyre sportive, prandaj si formë e vetme në rimëkëmbjen dhe avancimin e tyre mbeten programet e vazhdueshme të zhvillimit dhe avancimit të kapaciteteve njerëzore në menaxhim të sportit.

### Historiku

Zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese do të zbatohet konform akteve nën-ligjore që do të nxjerrën dhe do të synohet integrimi i parimeve:

- demokracia në strukturë, organizim dhe funksionim,
- përfshirja e femrave në aktivitetet menaxhuese, udhëheqëse / administrative dhe
- integrimi i sportit të minoriteteve në sportin e licencuar të Kosovës.

Janë mbajtur disa konferenca të kësaj natyre gjatë periudhave të mëhershme. Vazhdimisht është punuar në zbatimin e kësaj politike për të gjitha nivelet administrative, udhëheqëse e menaxhuese të këtyre institucioneve.

## Qëllimi / Objektivi

Politika e MKRS - departamentit të sportit për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve ka për objektiv forcimin institucional të Departamentit të Sportit, Komitetit Olimpik të Kosovës, Komitetin Paraolimpik, Federatave të Sportit dhe institucionet tjera të sportit, profilizimin dhe profesionalizimin, zhvillimin e aftësive që do t'ju mundësonte këtyre institucioneve që të planifikojnë - menaxhojnë sportin në strategji afatmesme dhe afatgjatë. Kjo bëhet edhe më domethënëse sidomos në këtë periudhë kur jemi duke përgatitur strategjinë për sport.

## Strategjia dhe Metodologjia e zbatimit

Metodologjia e realizimit të politikës programore për zhvillimin e aftësive menaxhuese në mbështetje Federatave të Sportit, KOK-u, DSK, në:

- Mbështetje e seminareve dhe trajnimeve për personelin udhëheqës/menaxhues brenda dhe jashtë vendit;
- Përkrahja në organizimin e seminareve nga Komiteti Olimpik, Komiteti paraolimpik, federatat e sportit për trajner e gjyqtarë të sportit, me angazhimin e specialistëve nga jashtë;
- Përkrahja e trajnimeve në ngritjen profesionale për menaxherët e sportit brenda dhe jashtë vendit.

## Partnerët / Bashkëpunëtorët

Për të realizuar atë që është planifikuar brenda kësaj politike programore, departamenti i sportit do të mbështesë projektet që hartohen nga MKRS, KOK-u, Komiteti Paraolimpik, Federatat e licencuara të sportit dhe që parashohin angazhimin e profesorëve universitar, specialistëve të dëshmuar në fushat e kërkimeve/hulumtimeve sportive, specialistëve trajnues dhe menaxhues të sportit.

## Financimi

Projektet për financim do të konsiderohen me prioritet, ato të cilat janë në bashkëfinancim me organizatat e sportit ndërkombëtar.

Në bazë të buxhetit do të realizohen edhe projekte që bashkë-financohen nga KOK-u, Komiteti Paraolimpik, Federatat, Komunitat, Ambasadat e huaja dhe shoqatat tjera.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORT DEPARTMENT

LISTË DISTRIBUIMI / CIRKULARNO PISMO / ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZA/TO:	z.Kujtim Shala - Ministër i Kulturës ,Rinisë dhe Sportit				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Veton Firzi - Sekretarë i Përgjithshëm /MKRS-së				
NGA/OD/FROM:	Ibër Alaj-Drejtor i Departamentit të Sportit /MKRS-së				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Aprovimi i politikës programore nr. 10 – Politika Programore për zhvillimin e aktiviteteve sportive Shkollore dhe Universitare				
Nr. i zyrës:	27	Lokacioni:	038/211 357	Data:	31
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	janar
Room No.:		Extension:	22 021 (centrex)	Date:	2015

Dokumenti i është bashkangjitur politika programore numër dhjetë (10) që mbulon programin e departamentit të sportit për zhvillimin e aktiviteteve sportive shkollore në nivel shtetëror.

Është planifikuar të jepet një mbështetje më e madhe për projektet që mbulojnë aktivitetet sportive shkollore të cilat mund të iniciohen nga komunat, regjionet dhe niveli shtetëror.

Një përkrahje më e madhe shkon edhe në drejtim të përkrahjes së Federatës së sportit shkollore të cilat organizojnë gara sportive në regjione dhe në nivel të Kosovës.

Partnerët me të cilët do të lidhet marrëveshje për realizimin e kësaj politike programore janë: Ministria e Arsimit, Federata e sportit shkollore.

Buxheti i kërkuar për realizimin e kësaj politike programore kap shumën prej 150,418.00€.

z. Veton Firzi

Sekretar i Përgjithshëm i MKRS-së

z. Kujtim Shala

Ministër i MKRS-së

Ministria e kulturës rinisë dhe sportit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT  
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

DEPARTAMENTI I SPORTIT / DEPARTMAN ZA SPORT / SPORTS DEPARTMENT

Politika Programore: (10) SPORTI SHKOLLOR DHE UNIVERSITAR

### Hyrje

Me qëllim të sensibilizimit dhe masivizimit të sportit shkollor dhe universitar, MKRS - Departamenti i Sportit nga viti 2009 ka hartuar politikë programore për mbështetje të sportit shkollor dhe universitar.

### Qëllimi / Objektivi

Duke qenë të bindur se potenciali i vërtetë i sportit të Kosovës qëndron tek të rinjtë, është hartuar edhe kjo politikë programore në mbështetje e sportit shkollor në nivel komunal, regjional dhe republikan. Për të siguruar më shumë mundësi për masivizim të sportit për të rinj numrin e pjesëmarrësve të cilët merren me sport si të atyre nëpër shkolla fillore dhe të mesme, MKRS - departamenti i sportit planifikon të përkrahë shoqatat e pedagogëve nëpër komuna, Shoqatat regjionale, Asociacionet studentore dhe Federatën e sportit shkollor të cilat kanë qëllim në ngritjen dhe organizimin në nivel garues nëpër shkolla dhe universitete duke përdorur sistemin piramidial të krijimit të aktivitetit sportiv shkollor - universitare deri në nivel republikan.

Organizimi i sportit shkollorë duke filluar nga garat nëpër shkolla fillore, të mesme, universitete, duke kaluar në nivel komunal, në nivel regjional dhe në atë republikan, në këtë program qëllimi kryesorë është pjesëmarrja dhe identifikimi i talentëve të rinj dhe orientimi profesional i tyre. Organizimi i garave shkollore mbahet në disa lloje të sporteve nëpër ato vende ku ka kushte për zhvillimin e atij sporti konform infrastrukturës sportive. Njëkohësisht, parashihet që këtë organizim të mbikëqyrë shoqata e pedagogëve të kulturës fizike, asociacioni i sportit universitar dhe federata e sportit shkollorë.

Këto organizime të sportit shkollorë, universitar do të mbahen në bashkëpunim me Ministrinë për Arsim, federatat e sporteve, me Drejtoritë komunale të Arsimit dhe Sportit, dhe OJQ tjera.

Mbështetje logjistike – profesionale për krijimin e federates (shoqatës) universitare,

- Mbështetje te garave per aktivitet universitare - universiada ne nivel te Kosoves.
- Mbështetje per sportet gjegjese per seleksionet per pjesemarrje ne Universiada ne nivel Kombetare, dhe nderkombetare,

### Metodologjia e zbatimit

Garat shkollore, universitare do të organizohen dhe zbatohen nga federata e sportit shkollore, shoqata e pedagogëve të kulturës fizike, asociacioni i sportit universitar, ndërsa financimi do të bëhet nga MKRS - departamenti i sportit dhe organizatat tjera buxhetore.

Organizimi i garave do të ndihmohet në këto nivele:

- Organizimi i garave ne nivel komunal
- Organizimi i garave në nivel regjional
- Organizimi i garave në nivel republikan
- Pjesëmarrja e garuesve në "olimpiadën shkollore"
- Organizimi i garave në nivel universitar
- Organizimi i universiadës

### Financimi

Financimi i prioriteteve të caktuara do të bëhet nga MKRS - departamenti i sportit në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Federatën e sportit shkollore, Drejtoritë komunale përkatëse, organizatat joqeveritare, universitetet gjegjëse.